

Republika e Kosovës

Organ Shqyrtues i Prokurimit

Adresa: Rr. "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës, Kati V-të), Prishtinë, Kosovë

Tel: + 383 38 212 309

Lënda: Blerja e pajisjeve të TI-së për SKGJK dhe Gjykata – Ri Tender

Numri i prokurimit: 328-26-4402-5-5-8 / 33300/026/011/111

**Lënda: ANKESË NË ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT**

02.07.2026, Prishtinë

I nderuar Organ Shqyrtues i Prokurimit,

Bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik të Kosovës 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Udhëzuesin Nr.001/2023 Për Prokurim Publik si dhe RREGULLOREN NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ne, operatori ekonomik Claster tech Sh.P.K parashtrojmë ankesë kundër vendimit të datës 23.06.2026 lidhur me proceduën "Blerja e pajisjeve të TI-së për SKGJK dhe Gjykata – Ri Tender" me numër prokurimi: 328-26-4402-5-5-8 / 33300/026/011/111, nga Autoriteti Kontraktues Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Pas pranimit të letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 19.06.2026 kemi parashtuar kërkesë për rishqyrtim, me pretendimin se jemi eliminuar në mënyrë të pa bazë.

Arsyeja e AK, ku na eliminon si të papërgjegjshëm është: "Nuk e permbush kriterin e procesorit tek Kompjuteri Laptop ku kerkohet "minimum intel Core i7, minimum Gjenerata e parafundit ne daten e publikimit te njoftimit". Oferta ka qene Intel core i7- 13620H qe eshte procesor i gjenerates se 13 ndersa gjenerata e fundit e procesoreve ne treg ne daten e publikimit eshte Intel Core Ultra Series 3 (Panther Lake) e cila ka dale ne treg nga 27.01.2026 qe nenkupton se procesori duhet te jete minimum Core Ultra Series 2"

Kemi parashtuar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar në tërësi, me arsyetimin "nuk kemi nderrim te emertimit nderkohe gjate ketij procesi te prokurimit mire po ndryshimet ne emertim kane ndodhur para fillimit te procesit te tenderimit dhe si te tilla duhen respektuar.

Ne baze te deklaratave zyrtare te prodhuesit nga viti 2023 emertimi i gjeneratave ka nderruar dhe me sakte:

Ne dhjetor te 2023 eshte lansuar gjenerata e re me emertimin e ri Core Ultra Series 1 (Meteor Lake).

Ne tetor te viti 2024 eshte lansuar gjenerata tjeter Core Ultra Series 2 (Lunar Lake /

*Arrow Lake)*

*Ne janar 2026 eshte lansuar gjenerata e fundit e procesoreve Core Ultra Series 3 (Panther Lake)*

*Me kete raast gjenerata e fundit ne treg ne ne ditene "Fteses per Ofertim" eshte Core Ultra Series 3 (Panther Lake) qe bazuar ne kete kriter gjenerata parafundit eshte Core Ultra Series 2 (Lunar Lake/ Arrow Lake).*

*Ndersa sa i perket kushtit i5 dhe i7 sipas deklarimit zyrtar te prodhuesit emertimet ekuivalente per gjeneratat e reja jane 5 dhe 7 ( shembull Core Ultra 5 235).*

*Prandaj ne baze te ketyre te gjeturave komisioni qendron ne vleresimin e pare ne te cilin po ashtu eshte sqaruar ne detaje kjo ceshtje."*

*Ky arsyetim nga AK, është i pabazuar, për shkak se fillimisht, emërtimi i procesorëve ka ndërruar në vitin 2023, siç është cekur edhe nga AK. Kontrata kornizë me AQP është shpallur dhe nënshkruar në vitin 2024 pasi që ka ndodhur emërtimi i ri Core Ultra Series 1. AQP në kontratë kornizë ka vendosur të vazhdojë me emërtimin Intel Core I (në këtë rast i5 dhe i7).*

*Në bazë të kontratës kornizë nga AQP, ne si OE kemi vendosur të ofertojmë sipas kërkesës minimale të Autoritetit Kontraktues, e cila ka qenë i7 gjenerata e parafundit nga data e publikimit.*

*Në specifikat teknike të ofertuara nga ne (bashkangjitur me këtë ankesë) mund të shihni qartë se kemi ofertuar Laptop me procesor te gjenerates se parafundit te Intel Core i7 ( me Intel® Core™ i7-13620H Processor), e cila e përmbushë kërkesën minimale teknike te kerkuar nga AK "minimum intel Core i7, minimum Gjenerata e parafundit ne daten e publikimit te njoftimit". Kjo e bën ofertën tonë të përgjegjshme, për shkak se gjenerata e fundit e series Intel Core I3/i5/i7/i9 është gjenerata e 14-te, ndersa gjenerata e parafundit e kesaj serie eshte Intel Core i3/i5/i7/i9 e gjenerates se 13-te.*

*Ne vijim gjeni kerkesen ne dosjen e tenderit:*

Titulli: Blerja e pajisjeve të TI-së për SKGJK dhe Gjykata Numri I Prokurimit 328-26-4402-5-5-8 , dhe nr të brendshëm të prokurimit 33300/026/011/111

Brand Name PC – Modeli II	
Prodhuesi	Brand Name
Sistemi Operativ	Windows 11 Pro 64 bit supported
Procesori	Min. Intel Core i5, min Gjenerata e parafundit në datën e publikimit të njoftimit (ftesë për ofertim në fazën e mitenderëve)
Memorie	Min. 16Gb DDR4
Disku	Min 1 TB SSD NYMe M.2
Kartela grafike	Minimum dy porte: HDMI + DP''.
Porte	Min. 4 x USB 3.0, 2 X USB 2.0, pra total min 6 porte USB, apo më të avancuara
Rrjeti	Min 1 x RJ45 Gigabit port
Mausi dhe tastiera	USB Mause & QWERTY Keyboard
Tjera	EU-US ENERGY STAR
Audio	Integrated sound card
Power	EU Standard
Garancioni	3 vite

## II. Specifikacioni teknik minimal i për Kompjuterë Laptop

Specifikacioni teknik minimal:

Prodhuesi: **Brand Name Laptop - Model III**

Sistemi Operativ: Windows 11 Pro 64 bit supported

Procesori: Min. Intel Core i7, min Gejerata e parafundit ne daten e publikimit te njoftimit

Memorie: Min 16GB DDR4

Disku: min. 512GB SSD M.2

Kartela Grafike: Integrated UHD Graphics

Monitor: Min. 12,5"

Bateria: Battery Life 8+ hour

Porte shtese: Min. 1 x USB 3.0- 3.2, 1 USB 2.0, 1 x Type C, HDMI or Display Port

AV: min 720p HD camera, HD Audio speakers, Integrated microphone

AC Included + BAG (e njëjtë me brendin e laptopit)

Tjera: EU-US ENERGY STAR

Keyboard&Touchpad: Keyboard with Qwerty

Çantë: brand i njëjtë me laptop

Garancioni: 3 vite

*Deshmi nga dosja e tenderit*

Sa i përket çështjes së gjeneratave, ju lutem gjeni më poshtë edhe dëshminë nga prodhuesi Lenovo (do ta bashkangjesim edhe si dokument):



**End User: Keshilli Gjyqësor I Kosoves**  
**Address: Rr.Luan Haradinal nr.133, 10000, Prishtinë Kosovo**  
**Project Name: Blerja e pajisjeve te TI-se per SKGJK dhe Gjykata - Ritedner**  
**Numri I prokurimit: 328-26-4402-5-5-8**  
**Sipas Marreveshjes Publike Kornizë - Furnizim me pajisje te Teknologjise Informative me numer prokurimit: UA/2016-24-3927-1-1-4, Numri I Kontrates: UA/2016-24-3927-1-1-1/C549 DERI C568.**

#### Manufacturer's Authorization Form

We, Lenovo Technology B.V., subsidiary Ljubljana, Dunajska cesta 167, 1000 Ljubljana, Slovenia, who are established and reputable manufacturer of notebooks, desktops, workstations, monitors, tablets and accessories, having factories at Shangdi Information Industry Base, No 6 Chuang Ye Road, Haidian District, 100085 Beijing, China, do hereby state that the offered notebook model equipped with the 13th-generation Intel Core i7-13620H processor represents the penultimate generation of the Intel Core i-series. As the 14th generation stands as the final iteration of the i-series, and no 15th generation exists under this naming convention, this configuration satisfies the minimum requirements of the request."

Ljubljana, 22.6.2026

Jovan Glamočanin  
General manager Lenovo Adriatics  
E-mail: [jglamocanin@lenovo.com](mailto:jglamocanin@lenovo.com)  
Tel.: +386 40 196 063

Lenovo Technology B.V. Amsterdam,  
Podružnica Ljubljana

Në bazë të fakteve të paraqitura më lart, mund të shohim se eliminimi i OE Claster**tech**, shkel nder te tjerat, nenin 7 te LPP-se, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, duke na eliminuar pa bazë dhe duke e anuluar procedurën në mënyrë jo të drejtë.

Kërkojmë nga ju si Organ Shqyrtues i Prokurimit, të bëni shqyrtimin e kësaj lënde, duke u bazuar në faktet e paraqitura më lart, si dhe dokumentet mëshetëse të bashkangjitura:

- 1.FTESE PER OFERTIM 05.06.pdf
- 2.Procesverbali ihapjes 1 (1)
- 3.Vendimi i AK dhe Letrat standarse 19.06.2026... (1)
- 4.Kerkesa per rishqyrtim 22.06.2026
- 5.CPA KGJK - 22.6.2026
- 6.Pergjigje e kerkeses per rishyrtim 23.06.2026 (1)
- 7.Specifikimet teknike

Me respekt,  
Arton Vllasa

  
CEO – Claster**tech** 